



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:185324

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503472

P.nr.318/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarit: E. M., për shkak të veprave penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzave së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.552/2021 të dt.27.08.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.25.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Besart Mustafa dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin F. H. të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli Aktgjykimin, ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

E. M., me nofkën L. nga i ati I. dhe nëna A., mbiemri i vajzërisë së nënës B., i lindur më datë ....., me vendbanim në rrugën "A. H.", Komuna e Podujevës, me numër personal të identifikimit:....., ka të kryer shkollën e mesme, profesioni i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike-sociale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

I. Me datë 09.08.2021, rreth orës 03:20, në Podujevë, në udhëkryqin e Rr. "H. T." dhe "Xh. M.", pjesëtarët e policisë, tek i pandehuri E. M. kanë gjetur dhe konfiskuar një armë zjarri te tipit nr.M.... me një karikator dhe dy fishekë, të cilat i pandehuri i ka mbajtur në pronësi në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

- me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPR të Kosovës.

II. Në të njëjtin ditë vend dhe kohë si në dispozitivin e parë i pandehuri e ka përdorë armën e lartcekur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, duke shtënë me armë një herë në ajër, ku në vendin e ngjarjes pjesëtarët e policës e kanë gjetur një gëzhojë.

- me këtë ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPR të Kosovës.

III. Në të njëjtën ditë vend dhe kohë si në dispozitivin e II, i pandehuri Endrit Maliqi pasi që ka shtënë me armë në ajër e ka urdhëruar A. Xh. që ta gjejë gëzhojën, i cili ka kundërshtuar për çka ka filluar përleshja në mes tyre, në këtë moment ka dalë i dëmtuari –vëllau i A., A. dhe ka tentua të ndaj, kështu që i pandehuri E. me dashje që ti shkaktoj lëndime trupore e ka goditë me mjet të fortë të dëmtuarin A. me ç'rast i ka shkaktoar lëndime të lehta trupore.

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 76, 185, 366 dhe nenit 367 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 322, 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së i:

## P Ë R C A K T O N

Për veprën e parë si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, e gjykon dënim me gjobë në shumën prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë/€uro), të cilin dënim duhet të paguaj brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Për veprën e dytë si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, të cilin dënim do t'a vuaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 500.00€ (pesëqind/€uro), të cilin dënim duhet të paguaj brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Për veprën e dytë si në dispozitivin III, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, të cilin dënim do t'a vuaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë/Euro), të cilin dënim duhet të paguaj brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Me aplikimin e nenit 76 të KPRK-së, e:

### G J Y K O N

- I. DËNIM UNIK GJOBË në shumë prej njëmijë (1,000.00) Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej tre (3) muaj, në tre këste të barabarta mujore, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë..
- II. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo njëzet (20.00) Euro të papaguara do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.
- III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet euro/Euro), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet euro/Euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet euro/Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- IV. Konform neneve 366 dhe 367 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet: një armë zjarri te tipit nr.M906T me një karikator dhe dy fishekë, si mjete të kryerjes së veprës penale
- V. Të dëmtuarit: A. Xh. dhe A. Xh., që të dy nga Podujeva, rruga "Xh. M.", pn. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ushtruar aktakuzën, PP/I.nr.552/2021 të dt.27.08.2021, kundër të akuzuarit: E. M., për shkak të veprave penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor 25.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari me mbrojtësin e tij me autorizim av. F. H., ndërsa nuk kanë prezantuar të dëmtuarit, për të cilët gjykata ka lëshuar urdhëresë stacionit policor në Podujevë për verifikim adrese, të cilët sipas njoftimit zyrtar të datës 08.02.2024, kanë njoftuar gjykatën se A. dhe A. Xh. jetojnë në Gjermani.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me veprën penale që i vihet në barrë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij deklaroi: E pranoje fajësinë, është e vërtetë si ne aktakuzë, këto raste nuk do të përsëriten më asnjëherë, me të dëmtuarit jemi rregulluar, rasti ka ndodhur aty për aty, nuk kemi pasur kurrë asnjë të keqe por edhe nga ai moment nuk kemi pasur asnjë problem - jemi fqinjë dhe shokë, lus gjykatën që të me shqiptoi një dënim sa më të lehtë sepse ky rast nuk do të përsëritet më kurrë.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokat F. H. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: Pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës i tij dhe shqyrtimit të lëndës së bashku me provat ka ardhur në përfundim që pranimin e fajësisë të bëjë me vullnet të plotë, dhe i vetëdijshëm për benefitete të cilat i ofron ligji, i njëjti pendohet para gjykatës, duke i kërkuar falje gjykatës dhe prokurorisë, po ashtu i njëjti sqaroi se me të dëmtuarit është pajtuar përmes lidhjes familjare - prindërve dhe prej atëherë asnjëherë nuk e ka përsëritur jo këtë vepër por asnjë tjetër, raportet me të dëmtuarit i ka në mënyrë shumë të relaksuara.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjykata konform nenit 322 par. 2 të KPPRK-së, ka dëgjuar prokurorin e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit, sepse pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnetare, prandaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të akuzuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 322 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj, Gjykata konform nenit 322 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar deklaroi: Pasi që gjykata aprovoj pranimin e fajësisë i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit duke marr parasysh rrethanat lehtësues dhe ato renduese, si rrethana lehtësuese të marr pranimin e fajësisë, pendimi, ndërsa si rrethana renduese intensitetin e dashjes

Mbrojtësi i të pandehurit E. M., avokat F. H. në fjalën përfundimtare deklaroi: Gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor klienti im e bëri pranimin e fajësisë me vullnetin e tij të plotë natyrisht pas konsultimit me mua, nuk ka pasur qellim ta lëndojë asnjërin nga të dëmtuarit, për këtë u pendua thellë para gjykatës, që nga ai moment e deri tani asnjëherë nuk ka rëndesh me ligjin. Me fqinjët

e tij – të dëmtuarit ka raporte të mira dhe për këtë arsye është pajtuar me familjarët e tij, dhe nuk kanë asgjë të keqe mes vete, kjo mund të shihet edhe nga deklaratat e të dëmtuarve, të cilët deklarojnë se dëshirojnë këtë rast të mbyllin sa me shpejtë, mbi bazën e të lartshënuarave gjykatës i propozojmë që ta njoh këtë pranim të fajësisë, duke i vlerësuar, të gjitha rrethanat lehtësuese, të cilat i paraqiten tek matja e dënimit, E. M. ta dënoi me një dënim sa më të butë të mundshëm, në mënyrë që t'i jepet mundësia që të akuzuarit të risocializimet me jetën dhe të vazhdoj punën e tij.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi: Pajtohem me fjalët e mbrojtësit tim. I premtoj gjykatës se ky rast nuk ka me u përsëritur kurrë lus gjykatën që të me shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jam në procedurë të rregullimit të vizës.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjtit është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprave penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Konform nenit 71 par. 1 nën-par. 1.3 të KPK-së është përcaktuar se: “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “... në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”.

Konform nenit 72 par. 1 nën-par. 1.5 të KPK-së: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim “...nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimin dhe kërkim falja në raport me të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur siç është jeta dhe shëndeti trupor i njeriut. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra

penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 366 dhe 367 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal  
P.nr.318/2023 me dt.26.03.2024

**G j y q t a r i**

---

Minir Hoti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.